



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1295/ 5 Prot.,

Datë 10.06.2026

V E N D I M
Nr. 776 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.06.2026 me:

Objekt: Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Endri Dulellari” P.F për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur*”, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjete artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

Modifikim i dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Endri Dulellari” P.F, Nipt L71731025U
Adresa: Rr. Shyqyri Ishmi, Pll. 26/1. Shk. 1, Ap. 21, K. 5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Himarë.
Adresa: Rr. “25 Marsi”, Nr.2; Spile, Himarë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, informacionin e autoritetit kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6592, datë 27.04.2026 dhe me Nr. 1295/2026 Prot., date 28.04.2026 e operatorit ekonomik “Endri Dulellari” P.F, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit.

II.3. Me shkresën nr. 1295/1 prot., datë 06.05.2026 me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Endri Dulellari” P.F, Komisioni në mënyrë të përmbledhur kërkoi:*

[....] Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, me nr. A/2026/6592, datë 27.04.2026 dhe me Nr. 1295/2026 Prot., date 28.04.2026 u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar.

..... Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së

nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit dhe shqyrtimin e pretendimeve të operatorit ekonomik « Endri Dulellari » P.F, si dhe vendimin e autoritetit mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes....[....]

II.4. Autoriteti Kontraktor ka përcjellë me shërbim postar shkresën me Nr. 2680/24 prot., datë 25.05.2026, protokolluar me tonën me Nr. 1295/2 datë 28.05.2026, me objekt: “Përcjellje vendimi për pranimin pjesërisht të ankesës”.

Referuar shkresës, autoriteti kontraktor informon mbi Vendimin Nr.8, datë 25.05.2026 të KSHA-së, për pranim pjesërisht të pretendimeve të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë argumentuar si vijon:

ARGUMENT 10, Sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 Për sistemin e taksave vendore , i ndryshuar, brenda dates 20.04.2026 bizneset duhet te kene bere pagesat edhe per kestin e pare te taksave vendore per vitin 2026 dhe brenda dates 30.06.2026 te kene bere pagesat edhe per kestin e dyte, prandaj kerkojme qe vertetimi te konfirmoje qe OE nuk kane detyrime ne daten e zhvillimit te procedures, dhe jo vetem per vitin 2025.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar pretendimin:

Për sa më sipër operatori ekonomik ka të drejtë, në hartimin e DST duhej të ishin kërkuar edhe taksat vendore për vitin 2026. Ky ndryshim do të merret në konsideratë dhe do të pasqyrohet në shtojcën me ndryshime të DST-së.

PROBLEMATIKA 11, Në Kriteret e Vecanta për Kualifikim kerkohet:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar sipas përcaktimeve të regjistrimit tregëtar, me objekt të përcaktuar për organizim eventesh dhe shërbimesh artistike, kulturore, rekreative dhe promovuese për një periudhë jo më të vogël se 10 (dhjetë) vite. Periudha 10 vjeçare e përcaktuar nga AK nuk mbështet në asnjë përcaktim ligjor. Nuk ka asnjë afat të përcaktuar nga ligji për regjistrimin e OE. Mjafton që OE të plotësojë kriteret e procedurës dhe nuk ka asnjë kufizim se sa vite ka që është regjistruar si biznes. E vetmja kërkesë që ka ligji është që OE ofertues ta ketë objektin e tenderit objekt veprimtarie, pa asnjë kufizim kohor. Lutemi të hiqet fraza: për një periudhë jo më të vogël se 10 (dhjetë) vite . Lidhur me këtë çështje lutem referojuni Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1890 prot., datë 07.02.2018, ku thuhet: Sjellim në vëmendje të autoriteteve kontraktore se, verifikimi i fushës së veprimtarisë së të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në faqen zyrtare të QKB, nuk duhet të jetë shkak për abuzime nga autoritetet kontraktore, të cilat në çdo rast duhet të mbajnë në konsideratë se objekti i prokurimit duhet të jetë i përfshirë në fushën e veprimtarisë dhe jo domosdoshmërisht të jetë i njëjtë me të.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar pretendimin:

Edhe pse kërkesa është menduar si një kriter i rëndësishëm në zbatim të kontratës do të merren parasysh kërkesa e operatorit ekonomik ankimues dhe do të modifikohet si kriter duke reduktuar viet e eksperiencës nga 10 (dhjetë) në 3 (tre) vite.

PROBLEMATIKA 12, *Ne Kriteret e Vecanta per Kualifikim kerkohet: 2.3.4 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik kyç për ekzekutimin e objektit te prokurimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, jetëshkrim (CV) , diploma, trajnime ose ekuivalent si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:*

-Minimumi 1 (nje) Drejtues Artistik, me min 5 (pesë) vite eksperiencë profesionale.

-Minimumi 1 (nje) Grafik Dizainer(Graphic Designer), me min 2 (dy) vite eksperiencë profesionale

-Minimumi 1 (nje) Menaxher Eventi, me min 10 (dhjetë) vite eksperiencë profesionale.

... Ligji gjykon qe 3 vite pervoje jane mjaftueshem per te vleresuar biznesin qe do te realizoje gjithë proceduren, do te plotesoje te gjitha kerkesat e sherbimeve. AK kerkon 10 vite pervoje per nje person i cili do te kryeje vetem nje pjese te sherbimeve, pra nuk ka rendesine qe ka OE si entitet. Ne kete kuptim vitet e pervojers te kerkuara jane tejte te ekzagjeruara. Ashtu sikurse per OE, ne procedura per kontrata sherbimesh nuk kerkohet pervoje me e gjate se 3 vite, kerkojme qe edhe per specialistet te kerkohet pervoje jo me e gjate se 3 vite.

Lutemi te ndryshohen vitet e pervojes per te tre specialistet, duke kerkuar pervoja jo me shume se 3 vjecare per secilin.

Autoriteti Kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka pranuar pretendimin në lidhje me:

Mbi vitet e eksperiences se stafit te punësur dhe Autoriteti Kontraktor do të marrë në konsideratë duke kërkuar përvojën jo më shumë se 3 (tre) vjet.

Përsa më sipër konstatohet se Autoriteti Kontraktor me Vendimin me Nr.8, datë 25.05.2026 të KSHA-së, ka vendosur pranim pjesërisht të pretendimeve të ankesës e konkretisht mbi modifikim të dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit si vijon:

[...]Për këto arsye KSHA vendos të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik.

- Pretendimi i shprehur në Pikën 10 Pranohet.*
- Pretendimi i shprehur në Pikën 11 Pranohet*
- Pretendimi i shprehur në Pikën 12 Mbi modifikim të përvojës deri në tre vjet për Specialistët, Pranohet.*

KSHA Vendosi

- Pranimin pjesërisht të Ankesës,*
- Reflektimin e saktësimeve dhe modifikimeve përkatëse në dokumentet standarde të tenderit.*
- Ky Vendimi i njoftohet operatorit ekonomik dhe Komisionit te Prokurimit Publik. [...]*

III.1.2. Referuar Nenit 30 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

Neni 115 pika 1 dhe 3 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.3. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik si edhe Vendimit të KSHA-së, mbi pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni do të mbyllë shqyrtimin e pjesës së pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Endri Dulellari” P.F, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tjera të ngritura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Endri Dulellari” P.F me argumente: Referuar shtojcës 7

1 Në Njoftimin e Kontrates është përcaktuar: **2.16** Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër: Po X Jo **2.5 Lloji** i Marrëveshjes Kuadër: Me një Operator Ekonomik ? Me disa Operatorë Ekonomikë X Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po X Jo ? **2.7** Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë: Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 2 (dy AK ka zgjedhur ta organizojë kete procedure si marreveshje kuader me disa OE, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara. Rregullat sesi funksionin kjo menyre prokurimi jepen ne Rregullat e Prokurimit Publik, VKM APP 285, date 19.05.2021, i ndryshuar, neni 64, pika 3, ku thuhet: 3. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e

autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Kjo lloj marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues. Përcaktimet ligjore janë detyruese për ndarjen e procedurës në lote dhe asnjë argumentim nuk mund të dale mbi përcaktimet ligjor.

Lutemi anuloni Procedurën dhe ndajeni në Lote sipas seciles feste që është planifikuar të organizohet, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator Ekonomik Fitues, sikurse përcakton ligji. Lutemi ndani çdo feste në lot të vecante, pasi asnjëra prej festave nuk ka asnjë lidhje me festat e tjera.

AK ka menduar që kjo procedure do të kishte dy fitues, nderkohe në proces-verbalin e argumentimit për mos ndarjen në lote të procedurës thote: Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar natyrës së shërbimit, specifikimeve teknike, kemi të bëjmë me një artikull të vetëm Aktivitete gjithëvjetore artistike dhe kulturore dhe për këtë arsye AK e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë. Kjo procedurë duhet të kryhet nga OE të cilët do të shpallen fitues, pasi kemi të bëjmë me të njëjtin shërbim. Përsa kohe që kjo procedure ishte planifikuar të ketë dy operatore fitues, pra disa festa do të organizohen nga një OE, dhe disa festa të tjera do të organizohen nga një OE tjetër, bie poshtë pretendimi se procedura nuk mund të dahet në lote sepse janë shërbime të ngjashme, sepse praktikisht do të behet një ndarje e festave.

Procedura është mbi kufirin e lartë monetar dhe në këtë rast ligji kërkon një argumentim të qartë, real dhe teknik se cilat janë arsyet që nuk lejojnë ndarjen në lote. Arsyeja janë shërbime të ngjashme, por nderkohe do të zbatohen nga dy OE nuk është argument. Behet fjale për një fond 50 miliona leke të reja pa tvsh, argumentimi për mos ndarje të lote duhet të bazohet në shpjegime ligjore dhe teknike, çfarë e pengon konkretisht procedurën të ndahet në lote, në cmenyre lidhen të gjitha keto festa me njëra-tjetrën, aq sa behet e pamundur ndarja në lote.

Ne DST përcaktohet: 2.7 Marrëveshje Kuadër me disa OE: Nr i OE, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 2 (dy)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit: NUK DO TË KETË RIHAPJE TË KONKURSIT. Kontrata/kontratat do të lidhen sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm. Dhënia e kontratës/kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT.

Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër. Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë ftesën për ofertë tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasi të përkatëse të artikujve. Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik fitues, të japë ofertën e tij. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet në formë të shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të behet pjesë e dosjes së procedurës. **Sasitë e parashikuara dhe të kërkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato.**

Perderisa nuk do të ketë rihapje të konkursit, si mund të zbatohet një marrëveshje kuadër me të gjitha kushtet të përcaktuara, me dy OE njëkohesish???

III.2.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Dokumentet Standarde, ka përcaktuar: **Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”**

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-82186-04-16-2026

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime çlodhjeje, kulturore dhe sportive 92000000-1

2.3 Lloji i Kontratës: “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po X Jo ☐

2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:

Me një Operator Ekonomik ☐

Me disa Operatorë Ekonomikë X

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po X Jo ☐

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 2 (dy)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike Në zbatim të nenit 52/4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: b) kur marrëveshja kuadër përcakton të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë, pjesërisht pa rihapur konkurrimin në përputhje me shkronjën “a” të kësaj pike, dhe pjesërisht me rihapjen e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, në përputhje me shkronjën “c” të kësaj pike, kur kjo mundësi është parashikuar nga autoritetet ose entet kontraktore në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Zgjedhja nëse punët, furnizimet ose shërbimet specifike blihen pas rihapjes së konkurrimit ose direkt sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër bëhet në përputhje me kritere objektive, të cilat përcaktohen në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Në këto dokumente duhet, gjithashtu, të specifikohet se cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit.	Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontrata/ kontratat do të lidhen sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm. Dhënia e kontratës/ kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT. Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër. Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasi të përkatëse të artikujve. Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik fitues, të japë ofertën e tij. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës. Sasi të parashikuara dhe të kërkuara janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato.
--	--

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: (këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1.Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës **49,518,900** (Dyzet e nëntë milionë e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë **pa tvsh.**

Ose 516,467 EUR (Pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë Euro) **pa TVSH** me kursin e datës 09.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro= 95.88 leke)

III.2.2. **Proces-Verbali** PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË.

OBJEKTI I PROCEDURËS:“Organizim i aktiviteteve gjithëvjete artiskike dhe kulturore”

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 49,518,900 (Dyzet e nëntë milionë e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë **pa tvsh.**

Ose 516,467 EUR (Pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë Euro) **pa TVSH** me kursin e datës 09.04.2026 të BSH me vlerë 1 euro= 95.88 leke)

[...]Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar natyrës së shërbimit, specifikimeve teknike, kemi të bëjmë me një artikull të vetëm “Aktivitete gjithëvjete artistike dhe kulturore” dhe për këtë arsye Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë.

Kjo procedurë duhet të kryhet nga operatorët ekonomik te cilet do të shpallen fitues, pasi kemi të bëjmë me të njëjtin shërbim. ... ne referim edhe te nenit 2 i Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar...[...]

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit “162/2020 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. **Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale**

III.2.4 Në nenin 52, “Marrëveshjet kuadër” i Ligjit “162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se:

1. Marrëveshja kuadër është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara. Afati i marrëveshjes kuadër nuk është më i gjatë se 4 vjet. Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektoriale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 vjet.

2. Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj. Këto kontrata mund të zbatohen vetëm ndërmjet atyre autoriteteve ose enteve kontraktore që janë identifikuar qartë për këtë qëllim në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi dhe atyre operatorëve ekonomikë që janë palë të marrëveshjes kuadër që është lidhur. Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër në asnjë rrethanë nuk mund të përfshijnë ndryshime thelbësore të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e përmendur në pikën 3 të këtij neni. 3. Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër. Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër ofertën e tij, sipas nevojës.

4. Kur marrëveshja kuadër lidhet me më shumë se një operator ekonomik, atëherë kjo marrëveshje kuadër zbatohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) nëpërmjet zbatimit të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimin;

b) kur marrëveshja kuadër përcakton të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë, pjesërisht pa rihapur konkurrimin në përputhje me shkronjën “a” të kësaj pike, dhe pjesërisht me rihapjen e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, në përputhje me shkronjën “c” të kësaj pike, kur kjo mundësi është parashikuar nga autoritetet ose entet kontraktore në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Zgjedhja nëse punët, furnizimet ose shërbimet specifike blihen pas rihapjes së konkurrimit ose direkt sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër bëhet në përputhje me kritere objektive, të cilat përcaktohen në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Në këto dokumente duhet, gjithashtu, të specifikohet se cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit.

III.2.5. Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për procedurat e prokurimit dhe përcaktimi i tyre sipas nevojave dhe kërkesave të tij është një detyrë e njësive përkatëse për planifikim në kohë dhe argumentimin e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e procedurave të prokurimit si edhe hartimin e dokumenteve standarde të duhura në përputhje me Legjislacionin për Prokurimrt Publike..

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe si rrjedhojë është në të drejtën e tij për të përcaktuar llojin e procedurës sasinë e mallrave/shërbimeve, specifikime teknike të mevojshme si edhe kriteret për kualifikim në funksion të realizimit me sukses të procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në procedsin e realizimit në tërësi të procedurës së prokurimit. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote, kohëzgjatja e paparashikuar etj.

Gjithashtu, referuar nenit 39, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar 1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale, në rastin konkret ndarja në lote e procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e Autoritetit

Kontraktor kur ai e vlerëson si opsionin e duhur për procedurën e prokurimit. Komisioni vëren se Autoriteti Kontraktor ka vendosur të mos e ndajë procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi në Lote duke përcaktuar që procedura të zhvillohet si Marrëveshje Kuadër, me të gjitha kushtet e përcaktuara, me disa operatorë ekonomikë, vendosuar në Pika 2.4 e në vijim të DST-së.

Referuar ankesës Operatori ekonomik i cili ngre pretendime: [...] *AK duhet të ndajë në Lote procedurën si edhe anulimin e saj, ... apo edhe paqartësi mbi përcaktimin nga ana e AK-së të vendosjes se Marrëveshjes Kuadër me 2 OE , paqartësi mbi zbatimin e saj, festat janë të natyrave të ndryshme... Persa kohe qe kjo procedure ishte planifikuar te kete dy operatore fitues, pra disa festa do te organizohen nga nje OE, dhe disa festa te tjera do te organizohen nga nje OE tjeter, bie poshte pretendimi se procedura nuk mund te dahet ne lote sepse jane sherbime te ngjashme, sepse praktikisht do te behet nje ndarje e festave.[...]*

Komisioni thekson, se përsa kohë AK ka përcaktuar mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit, si e drejtë që Ligji ia njej Autoriteteve Kontraktore, duke vendosur Marrëveshjen Kuadër për zhvillimin e procedurës së prokurimit, është detyrim jo vetëm të mirëargumentojë vendimmarrjen e tij por edhe të përcaktojë qartë dhe saktë kushtet specifike dhe të dhënat e domosdoshme për të justifikuar këtë përzgjedhje të tij.

Komisioni duke vlerësuar pretendimet e ankimuesit mbi një sërë faktesh të cilat vlerësohen deri diku të drejta, në lidhje me kundërshtimin e zgjedhjes së Marrëveshjes Kuadër me 2 operatorë ekonomikë, gjykon se Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë zgjedhjen e tij në lidhje me këtë vendim, konkretisht duke vlerësuar faktin se Autoriteti kërkon të organizojë një numër të lartë aktiviteteve dhe përcaktimi i 2 operatorëve ekonomikë vlerësohet si numër i ulët duke kufizuar pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Në analizë të fakteve të parashtruara nga palët, Komisioni gjykon që Autoriteti Kontraktor duhet të rrisë numrin e operatorëve ekonomikë që do të marrin pjesë në Marrëveshjen Kuadër për këtë procedurë prokurimi, me qëllim hapjen e konkurrencës dhe realizimin e saj ndërmjet disa operatorëve ekonomikë të niveleve të ndryshme të biznesëve në treg.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi kundërshtimin e hartimit të Dokumentet e Tenderit, argumentuar si vijon:

[...] *Ne Njoftimin e Kontrates eshte percaktuar: 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera. Po X Jo ? Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja: Ndalohet mbështetja per pika 2.3.3 dhe 2.3.4, pasi keto kritere jane shume te rendesishme te plotesohen nga operatori qe do te kontraktohet per kete sherbim dhe konsiderohen si te lidhura ngushte me kapacitetet e operatorit...*

AK kerkon qe keto dy kritere te plotesohen domosdoshmerisht nga OE ofertues sepse keto kritere jane shume te rendesishme te plotesohen nga operatori qe do te kontraktohet per kete sherbim dhe konsiderohen si te lidhura ngushte me kapacitetet e operatorit.

Ligji parashikon qe AK mund te vendose kufizime per kryerjen e nje sherbimi konkret për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi dhe jo te ndalohet mbeshtetja per krejtesisht kriterin, madje per dy kriteret.

Pra AK duhet te shpjegoje se cilin sherbim kritik te kontrates duhet te kryeje vete OE ofertues, dhe jo ti heqe OE teresisht te drejten e mbeshtetjes per dy kriteret, ku perfshihet edhe numri total 8 punonjes.

AK nuk ka dhene asnje sqarim se cila eshte konkretisht pjesa kritike e festes dhe si mund te cenohet organizimi i festes, nese disa nga keta 8 punonjes ose specialiste sigurohen permes mbeshtetjes ne kapacitetet e nje OE tjeter. Dhe per cilen feste konkretisht ekziston ky rrezik, pasi festat jane te llojeve te ndryshme, me shkalle veshtiresie te ndryshme. Gjithsesi ne rastin e mbeshtetjes, OE ofertues duhet te plotesoje vete se paku 50% te kriterit. Gjithashtu OE fitues do te mbaje pergjegjesine perpara AK per realizimin e kontrates nese shpallet fitues, dhe mbi te do te bien penalitetet, prandaj nuk ka asnje rrezikshmeri per AK. Gjykojme se kufizimi qe ka vendosur AK per ti hequr OE te drejten per tu mbeshtetur ne kapacitetet e nje OE tjeter per dy kriteret nuk gjen mbeshtetje ne percaktimet ligjore, prandaj kerkojme te hiqet ky kufizim. AK ka deshtuar te argumentoj apo tregoj ndonje pjese kritike te sherbimit / organizimit te ndonje eventit, prandaj kufizimi qe ka vendosur nuk eshte i argumentuar as teknikisht, as ligjerisht, nderkohe qe e ka detyrim ligjor te argumentoj cdo kriter si nga ana teknike edhe ligjore. Ligji nuk jep te drejta te pakufizuara, ne rast se kriteri nuk argumentohet ateherë ai nuk mund te vendoset. Me tej ne proces-verbalin e argumentimit te kriterëve nuk gjejmë asnjë sqarim për këto kriterë gjë që e bën kriterin të paargumentuar dhe të pabazuar në ligj.

Lutemi të lejohet mbështetja në kapacitetet e operatoreve të tjere për kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4.

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST,

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja:

Ndalohet mbeshtetja per pika 2.3.3 dhe 2.3.4, pasi keto kriteret janë shumë të rëndësishme të plotësohen nga operatori që do të kontraktohet për këto shërbime dhe konsiderohen si të lidhura ngushtë me kapacitetet e operatorit.

Shtojca 9

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik: Kriteret 2.3.3. dhe 2.3.4.

2.3.3. Një punësim mesatar i të paktën **8 (tetë) personave** të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b.** Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Argumentuar: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Përcaktimi i fuqisë punëtore minimale të kërkuar është bazuar në shpërbimet e kërkuara sipas Detyres së Projektimit objekt prokurimi. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar intensitetit të shërbimeve nevojitet operator ekonomik me staff të organizuar dhe të qëndrueshem për të garantuar shërbimet.

2.3.4 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik kyç për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, jetëshkrim (CV), diploma, trajnime ose ekuivalent si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Minimumi 1 (nje) Drejtues Artistik, me min 5 (pesë) vite eksperiencë profesionale.
- Minimumi 1 (nje) Grafik Dizainer (Graphic Designer), me min 2 (dy) vite eksperiencë profesionale
- Minimumi 1 (nje) Menaxher Eventi, me min 10 (dhjetë) vite eksperiencë profesionale.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Vendosja e kriterit për disponimin e stafit teknik kyç me kualifikimet dhe eksperiencën e përcaktuar është e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të objektit të prokurimit, i cili përfshin organizimin e aktiviteteve artistike dhe kulturore me kompleksitet të lartë organizativ, krijues dhe teknik.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën e shërbimeve dhe justifikohet si më poshtë:

Sigurimi i kapaciteteve profesionale të nevojshme: Organizimi i eventeve artistike dhe kulturore kërkon një kombinim të aftësive krijuese, menaxheriale dhe teknike. Përcaktimi i stafit kyç (Drejtues Artistik, Grafik Dizainer dhe Menaxher Eventi) siguron që operatori ekonomik disponon burimet njerëzore të nevojshme për të përballuar të gjitha fazat e realizimit të aktiviteteve.

Roli kritik i pozicioneve të kërkuara:

Drejtuesi Artistik garanton cilësinë artistike dhe konceptimin kreativ të aktiviteteve, duke siguruar përputhjen me objektivat kulturorë të Autoritetit Kontraktor;

Menaxheri i Eventeve është përgjegjës për planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin operacional të aktiviteteve, duke qenë kyç për respektimin e afateve, buxhetit dhe standardeve organizative;

Grafik Dizaineri siguron realizimin e materialeve promocionale dhe identitetit vizual të aktiviteteve, element thelbësor për promovimin dhe komunikimin publik.

Eksperienca profesionale si garanci për cilësi: Kërkesa për vite minimale eksperience është proporcionale me rëndësinë e rolit që secili pozicion ka në realizimin e kontratës. Në veçanti, kërkesa për 10 vite eksperiencë për Menaxherin e Eventeve justifikohet nga nevoja për menaxhim të aktiviteteve komplekse dhe me impakt publik të gjerë.

Disponueshmëria reale e stafit: Kërkesa që stafi të jetë i punësuar dhe i reflektuar në listëpagesat e 3 muajve të fundit synon të sigurojë që operatori ekonomik ka kapacitete reale dhe të qëndrueshme njerëzore, dhe nuk mbështetet në angazhime të përkohshme apo deklarative vetëm për qëllime kualifikimi.

Reduktimi i riskut në zbatim: Duke kërkuar staf të kualifikuar dhe të provuar, Autoriteti Kontraktor minimizon rrezikun e dështimit në organizimin e aktiviteteve, vonesave, apo realizimit me cilësi të ulët.

Përputhshmëria me parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit: Numri i stafit të kërkuar është minimal dhe i lidhur drejtpërdrejt me funksionet thelbësore të kontratës, ndërsa kriteret e eksperiencës janë në përpjesëtim me kompleksitetin dhe rëndësinë e shërbimeve që do të ofrohen.

Lehtësimi i pjesëmarrjes dhe respektimi i procedurës: Parashikimi që në fazën e ofertimit kërkohe vetëm vetëdeklarimi sipas formularit përmbledhës (Shtojca 10), ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga ofertuesi i renditur i pari, siguron një balancë ndërmjet verifikimit të kapaciteteve dhe shmangies së barrës administrative të panevojshme për operatorët ekonomikë.

III.3.2 Në nenin 84 “**Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera**” e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar përcaktohet:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, **aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.**

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohe aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.

III.3.3. Në Nenin 90 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.**

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.
2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:
 - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
 - t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
 - t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
 - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.
3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.
4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.
5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.
6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.
7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar materialeve të dosjes e konkretisht ankesës së operatorit ekonomik dhe trajtimin e saj nga autoriteti kontraktor vëren, se në lidhje me pikën 2.16 të DST-së, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se nuk e lejon **Mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera** në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Legjislacioni në fushën e prokurimeve publike ka parashikuar, që me qëllimin e dhënies së mundësive për pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi edhe të operatorëve ekonomikë të cilët nuk mund të plotësojnë të vetëm kapacitetet e nevojshme për realizimin e një kontrate prokurimi, lejon Mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, për operatorët ekonomikë, si një mundësi lehsuese për realizimin e procedurave të prokurimit me sukses.

Komisioni, nga shqyrtimi i dokumentit Terma të Referencës konstaton se kjo procedurë prokurimi ka një shtrirje të gjerë përgjatë vitin kalendarik, me shume aktivitete të ndryshme për të cilat

kërkohet punë e staf teknik e profesionistë si edhe parë në optikën për të nxitur pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë, Autoriteti Kontraktor duhet të lejojë Mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjerë, pa vendosur kufizime apo përcaktime për kriterë të veçantë, sikurse ka vendosur AK në DST, duke sjellë ankesa të cilat pengojnë zhvillimin e procedurës sipas parashikimeve të caktuara në kohën e parashikuar.

Për sa i përket pretendimeve të ankimuesit me argumente mbi modifikim të pikës 2.16 të dokumenteve standarde të tenderit, në lidhje me moslejimin në mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera për kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4, Komisioni i Prokurimit Publik i gjykon të drejta dhe të mirërgumentuara pretendimet e operatorit ekonomik, pasi personelin në tërësi dhe atë të kualifikuar në veçanti nuk mund ta kenë të gjithë operatorët ekonomikë dhe Autoriteti Kontraktor duhet të marrë masa për modifikim të pikës **2.16** të DST-së, bazuar në *Ligjin nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe aktet normative në zbatim të tij*, të cilat kanë përcaktuar mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për t'u mbështetur në kapacitetet teknike, profesionale dhe ekonomike të subjekteve të tjera ashtu sikurse kanë lënë në zgjedhjen e autoritetit kontraktor që të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës ofruesi të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ai me kushtin që ky informacion të publikohet në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës, të sigurohet, që operatori ekonomik, i cili do të shpallet fitues, të ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme teknike dhe profesionale për përmbushjen me sukses të kontratës, për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që Autoriteti Kontraktor duhet të modifikojë DST duke lejuar që operatorët ekonomikë të Mbështetjen në Kapacitetet e Subjekteve të tjera, si mundësi për pjesmarrje të tyre në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik argumentuar si vijon:

[...] Në Njoftimin e Kontrates është përcaktuar: **4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X Sipas rëndësisë:

1. Çmimi- pikët 50 pikët

2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë 15 pikët

3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit 15 pikët

4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar 20 pikë.

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit. Kriteret e vlerësimit: Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kjo menyre vlerësimi përdoret në procedura ku punët, furnizimet apo shërbimet vlerësohen në çdo drejtim dhe për çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë procesin e prodhimit apo një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor: 3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në: a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose

tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

Lutem te hiqet kriteri i perzgjedhjes se fituesit **Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto** pasi eshte vendosur ne shkelje te parashikimeve ligjore. ...

Lutemi te hiqet vleresimi me pike per pervojat e ngjashme pasi nuk ploteson detyrimin ligjor per argumentim te kriterit. Argumentimi i dhene nuk ka lidhje fare me kete procedure.....

Kriteri i vleresimit Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit eshte teresisht i paargumentuar, as ligjerisht e as teknikisht, gje qe ben kriterin te pavlefshem si te pabazuar ne ligj. Lutemi te hiqet vleresimi me pike per Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit pasi eshte i paargumentuar dhe i pa bazuar ne ligj..... gjithashtu

Lutemi te hiqet vleresimi me pike per Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar pasi eshte i paargumentuar dhe i pa bazuar ne ligj.

Kjo eshte nje procedure per sherbime eventesh, pa specifikime teknike dhe pa liste produktesh. Kjo procedure nuk ploteson kushtet ligjore per perzgjedhjen e fituesit me kriterin Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto. Neni 45 RrPP percakton qe ne keto procedura fituesi zgjidhet bazuar vetem ne cmimin, si i vetmi element i ndryshueshem ndermjet ofertave.

Ky argumentim nuk ka asnje lidhje me nje procedure sherbimesh per organizim eventesh,

Lutem percaktoni si kriter te perzgjedhjes se fituesit: oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim. [...]

III.4.1. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST, **Seksioni 4: Procedura : Projekte zbatimi, sherbim projektimi**

4.1 Lloji i procedurës: E Hapur, mbi kufirin e lart monetar

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ **Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto** X

Sipas rëndësisë:

1. Çmimi	pikët 50
2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë	pikët 15
3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit	pikët 15
4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar	piket 20

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0-50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Shënim: Oferta duhet të hartohet në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.5.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit.

2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë

[0 - 15 pikë]

Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të shërbimit të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/kontratat e ngjashme të kryera përtej minimumit të kërkuar garantojnë AK që me qëndrueshmërinë në treg, eksperiencën e stafit teknik dhe të vetë organizatës të fituar si dhe kapacitetin e lartë teknik kontraktori mbikqyrës nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së punimeve

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë kontrata me vlerën më të lartë për objekte të ngjashëm përtej minimumit të percaktuar në kriterin e kualifikimit pika 2.3.1/a, Shtojca 8 dhe që janë realizuar në periudhën kohore brenda tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ofertuesi me vlerën e kontratës së **objektit** të ngjashëm në vlerë absolute më të madhe do ti akordohen pikët maksimale të nën-kriterit dhe ofertuesit e tjerë të kualifikuar (minimalisht sa është percaktuar në pikën 2.3.1/a), Shtojca 8) do ti akordohen pikët sipas metodologjisë/formulës më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\max k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{maxk5} Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e objektit të ngjashëm)

P_{maxk5} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për të plotësuar këtë kërkesë ofertuesit mjaftojnë të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.1/a.

3. Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit

[0–15 pikë]

-Përqasja teknike dhe metodologjia

-Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: OE duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

4. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar

[0–20 pikë]

Organizimi dhe Stafi: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

- Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

-Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

-Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

Argumentimi: Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të punimeve të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/eksperiencat e ngjashme në të cilat ka qenë angazhuar stafi kyc i propozuar nga kompania demostrojnë aftësinë teknike dhe profesionale të personave që do të angazhohen gjatë zbatimit të shërbimit të mbikqyrjes, dhe garantojnë AK që me eksperiencën e fituar të tyre kontraktori nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës së punimeve që do të mbikqyret.

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë eksperiencat e secilit prej stafit kyc të propozuar.

III.4.2. Në nenin 87 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret të tilla mund të përfshijnë: a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në: a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës”

III.4.3. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese (të vlerësimit).

Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti përcakton kërkesat për kualifikim, për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, eksperiencës dhe metodologjisë të kryerjes së shërbimit.

Komisioni gjykon se një prej dallimeve esenciale ndërmjet kriterëve të kualifikimit me kriteret për shpalljen e kontratës fituese, është se kriteret e kualifikimit janë të detyrueshme për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pasi në të kundërt oferta e tyre refuzohet, ndërsa kriteret për shpalljen e kontratës fituese kanë karakter vlerësues për të evidentuar ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi dhe nuk përbëjnë shkak për kualifikimin/skualifikimin e ofertave.

Bazuar në nenin 87 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni gjykon se, pavarësisht se kriteret për shpalljen e kontratës fituese janë me karakter të ndryshëm vlerësimi nga kriteret e kualifikimit, parimi për hartimin e tyre është i njëjtë, të jenë në përputhje me volumin dhe objektin e kontratës që prokurohet, të jenë të qarta, të sakta, të mos krijojnë konfuzion, si dhe të garantojnë një konkurrencë efektive duke shmangur çdo lloj kufizimi të panevojshëm.

Gjithashtu, KPP thekson, se në rregullat e prokurimit publik, është përcaktuar qartësisht se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë një formulë të qartë mbi mënyrën e përlllogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Inter Allia dhe Mutatis Mutandis në Çështjen nr. Case 6/15- “TNS Dimarso NV v Vlaams Gevest” të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, paragrafi 20, GJED, ndër të tjera ka arsyetuar se: “[Omississ... Duhet të theksohet se aty ku autoriteti kontraktor vendos dhënien e një kontrate referuar ofertës ekonomike më të favorshme, sipas nenit 53 (2) të Direktivës 2004/18, ai duhet të specifikojë në njoftimin e kontratës ose specifikimin e tenderit peshën relative të peshimit të tij secilit prej kriterëve të përzgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomike më të

favorshme. Peshimi mund të shprehet duke parashikuar një hapësirë mes maksimumit të shpërndarjes. Kur, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, peshimi nuk është i mundur për t'u demonstruar arsyet, autoriteti kontraktues do të përcaktojë në njoftimin e kontratës ose specifikimet e tenderit ose, në rastin e një dialogu konkurrues, në dokumentin përshkruar, kriteret në rend zbritës bazuar në rëndësinë] ”

III.4.4. Në rastin konkret, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi metodën e Vlerësimit të Procedurës së Prokurimit me argumentet se: [...]AK të mdryshojë vlerësimin me pikë të cmimit të ofertës, si i paargumentuar, pasi ska specifikimet teknike liste produktesh, nuk ploteson kushte për perzgjedhje oferta ekonomike me e favorshme...[...] Komisioni gjykon se përsa kohë AK ka vendosur mënyrën e përlllogaritjes me anë të formulës përkatëse për

1. Çmimi

pikët 50

2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë

pikët 15

dhe ka argumentuar bazuar në VKM përkatëse, Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale, Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit, shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter, si eksperienca te ngjashme kriteri 2.3.1.

Përsa i përket Vlerësimit të ofertave sipas:

Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit

pikët 15

Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar

piket 20

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartësisht, mbi vlerësimin pikëve për Metodologjinë dhe Eksperiencës së Stafit Teknik dhe që do të realizohet sipas përshkrimit të ndarë sipas nënkritereve të përcaktuara në pikat, **por duhet të përcaktojë se sa pikë vlerësohet secili prej nënkritereve dhe sa pikë vlerësohet secili prej komponentëve të nënkritereve sipas shkallës së rëndësisë së tyre në rend zbritës ose të përcaktohet pesha specifike e secilit nënkriter dhe e komponenteve të tij dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo nënkriter dhe komponentët e tij dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.**

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë në kriteret e shpalljes së ofertës fituese ato kriteret të cilat lidhen drejtpërdrejtë me identifikimin e ofertës ekonomike më të favorshme, ashtu sikundër parashikohet edhe në nenin 87 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ligj i cili është i përafëruar edhe me katër direktivat europiane për prokurimet publik. Ligjvënësi ka parashikuar se këto kriteret mund grupohen në tre kategori: a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Komisioni sqaron autoritetin kontraktor, se vlerësimi është i matshëm në kushtet kur, niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me përvojën e ngjashme si edhe me eksperiencën e stafit teknik, në aplikim të formulës përkatëse si në rastin konkret.

Gjithashtu në vlerësimin e Metodologjisë së propozuar dhe Eksperiencës së stafit teknik, autoriteti kontraktor duhet të sqarojë në mënyrë më të qartë dhe shteruese, **komponentët konkretë të vlerësimit si dhe duhet të ketë një metodologji të qartë, se si do të vlerësohen pikët për këtë kriter, pra sa pikë vlerësohet secili prej komponentëve të këtij kriteri sipas shkallës së rëndësisë së tyre në rend zbritës ose të përcaktohet pesha specifike e secilit komponent dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo komponent dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.**

Autoriteti Kontraktor të rishikojë mënyrën e vlerësimit të ofertave sipas konstatimeve .

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë pjesërisht.

III.5. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik argumentuar si vijon:

ARGUMENTET 6, Ne P-V e argumentimit të kriterëve thuhet: Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer sipas nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 Për rregullat e prokurimit publik i ndryshuar, që përcakton çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit , të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit

Sikurse lexojme, për këtë procedurë prokurimi nuk është bërë asnjë studim për perlllogaritjen e fondit limit, pasi në argumentim flitet për një inxhinier që ka bërë një perlllogaritje për një procedurë për punime ndërtimi. Gjithashtu nëni 76, pika a, i VKM me nr.285, datë 19.05.2021 Për rregullat e prokurimit publik i ndryshuar, ku është bazuar perlllogaritja e fondit limit dhe e specifikimeve teknike (sic thuhet në këtë proces verbal) thote: **Neni 76 Mënyrat për perlllogaritjen e vlerës së prokurimit**

Parashikimet ligjore në asnjë rast nuk lejojnë të zhvillohet një procedurë prokurimi pa hartuar dhe publikuar specifikimet teknike por nuk ka as liste të produkteve për asnjë event. Këto mangësi të theksuara tregojnë gjithashtu se nuk është bërë studim për procedurën. **Edhe një herë kërkojmë anulim të procedurës, pasi nuk është perlllogaritur fondi limit, Nuk ka specifikime, dhe me e rendesishmja nuk ka liste me produkte. Është e pamundur të ofertohej pa liste me produkte/shërbime.**

ARGUMENTI 7. Duke parë **DST** e hartuara nga APP, shohim se **Shtojca 8, FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**, është një shtojcë e detyrueshme për tu plotësuar nga AK, dhëna që duhen plotësuar nga AK janë:

Shtojca 8. (Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Detyrat: Shpërndarja: Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne shtojcen 8 te publikuar ne proceduren objekt ankimi thuhet: Te gjitha eventet dhe datat jane subjekt i ndryshimeve ne varesi te nevojave te AK. Shpërndarja: OE. duhet të dorëzojë: Planin vjetor të aktiviteteve, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor; Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim); Vendi i kryerjes së shërbimeve: Gjithë territori i Bashkise Himare**

ARGUMENT 7.1 Kërkesa qe OE ofertues te dorezojne Planin vjetor të aktiviteteve, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor eshte pa kuptim. Planin vjetor të aktiviteteve, e miratuar nga Autoriteti Kontraktor; nuk ka as baze ligjore, as baze logjike ta beje OE. Ne kete faze te ofertimit asnje OE nuk kane document/plan te miratuar nga AK, madje eshte ne shkelje te ligjit te kete komunikime mes OE dhe AK. Lutemi te hiqet kjo kerkese, pasi na ben te dyshojme se ekziston nje OE qe ka pasur kontakte me AK.

ARGUMENT 7.2 AK kerkon qe OE ofertues te dorezojne: Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim); nderkohe qe po vete ka percaktuar: Te gjitha eventet dhe datat jane subjekt i ndryshimeve ne varesi te nevojave te AK. OE ofertues nuk ka si te percaktoje datat e eventeve perderisa vete AK ka percaktuar se datat do te vendosen ne varesi te nevojave te AK, pra datat jane ne dore te AK. Vendosja e afateve behet nga AK, jo nga OE. Lutemi te hiqet kerkesa qe OE ofertues te dorezojne: Kalendarin e detajuar të eventeve

ARGUMENT 7.3 Vendndodhja dhe shperndarja jane dy elemente ne Termat e References qe duhet ti plotesoje AK per secilin prej eventeve, nuk mund ta vendosin OE ofertues vendin ku do te zhvillohet aktiviteti. Kjo eshte nje procedure prokurimi ku AK ka detyrimin ligjor te hartoje kerkesa te sakta dhe te mirepercaktuara, per me teper eshte edhe marreveshje kuader me te gjitha kushtet te percaktuara. Vendndodhja eshte njera nga kater pikat ne shtojcen e Termave te References qe eshte percaktuar ta plotesoje AK. Lutemi te hiqet kerkesa qe OE ofertues te dorezojne: Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim)

ARGUMENT 7.4 Gjithashtu edhe pershkrimin e festave e ka bere AK ne Termat e References. Kjo eshte nje procedure prokurimi ku AK ka detyrimin ligjor te hartoje kerkesa te sakta dhe te mirepercaktuara, Pershkrimi i eventit behet nga AK. OE eshte vetem zbatues i procedures,. Lutemi te hiqet kerkesa qe OE ofertues te dorezojne: Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim).

III.5.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST dokumentin Shtojca 8, ka përcaktuar:

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti i kësaj kontrate është ofrimi i shërbimeve profesionale për organizimin, menaxhimin dhe realizimin e aktiviteteve artistike dhe kulturore gjatë gjithë vitit kalendarik, në përputhje me kalendarin kulturor të Autoritetit Kontraktor.

Qëllimi i shërbimeve është:

Promovimi i jetës artistike dhe kulturore në territorin e njësisë vendore;

Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete kulturore;

Mbështetja dhe promovimi i artistëve lokalë dhe kombëtarë;

Nxitja e turizmit kulturor dhe përmirësimi i imazhit të zonës

Detyrat:

Bazuar ne kalendarin e aktiviteteve te miratuara, me poshte specifikohen gjithë eventet artistike dhe kulturore qe priten te organizohen.

Nr	Aktivitete gjithëvjetore 2026
1	Mare Meum Festival
2	Aktiviteti: “Tingujt e Kinemasë Shqiptare”

3	Poetic Nights
4	Aktiviteti: “Fjale mbi det”
5	Aktiviteti: “Rrno per me tregue”
6	Festivali I Luleve -Edicioni i pare
7	Festa e Akullores
8	Himara Rin Fest 2026
9	Festa e Balonave
10	Himara ne 3D
11	Himara Photo Festival – Edicioni i Parë
12	Aktivitet Artistik Tematik
13	November Fest (Koncert me rastin e 28-29 Nentorit)
14	Aktivitete me rastine e festave te Fundvitit
15	Aktiviteti "Drone Art"
16	Aktiviteti per Pashket
17	Takim brezash
18	Shpenzime ne kuader te aktivitetit te Javes Europiane
19	Drama "Minush Aga"
20	Organizim Festa e 1 Qershorit (Disney Land)
21	Organizimi i Kampionatit te ping pong
22	Festa e përvitshme e ullirit dhe mjaltit
23	Open Cinema 3D
	TOTALI ME TVSH

Mare Meum Festival – Edicioni I Nga lindja në perëndim 4- Aktivitete

Mare Meum Festival është një ngjarje artistike ndërdisiplinore që lindi nga dëshira për të bashkuar përmes artit brigjet e Mesdheut — një hapësirë ku kultura, historia dhe muzika ndërthuren në një udhëtim të përbashkët shpirtëror. I zhvilluar në qytetet bregdetare të Shqipërisë, festivali ndërthur muzikën, poezinë, artet pamore dhe performancën, duke krijuar ura komunikimi midis traditës dhe bashkëkohësisë, midis rrënjëve lokale dhe ndikimeve ndërkombëtare.

Çdo edicion i Mare Meum ndërton një narrativë të re që eksploron marrëdhënien e njeriut me detin — si burim jete, frymëzimi dhe kujtese. Artistë nga vende të ndryshme të Mesdheut sjellin në skenë gjuhët e tyre artistike për të dëshmuar se deti është më shumë se një kufi: është një hapësirë që bashkon. Me koncerte, ekspozita, recitale poetike dhe bashkëpunime ndërkulturore, Mare Meum Festival po shndërrohet në një pikëtakim të rëndësishëm për krijuesit dhe dashamirësit e artit që besojnë se kultura është forca më e butë, por më e fortë, që lidh popujt e Mesdheut.

Pas suksesit të edicioneve të mëparshme, Mare Meum Festival rikthehet për të sjellë një eksperiencë të thellë artistike ku muzika ndërthuret me peizazhet e rralla të Himares.

Aktiviteti: “Tingujt e Kinemasë Shqiptare” - Muzika e Filmit Shqiptar.

Në kuadër të aktiviteteve kulturore që zhvillohen në qytetin e Himarës, është menduar të organizohet një mbrëmje artistike e veçantë me titull **“Tingujt e Kinemasë Shqiptare”**. Ky aktivitet do të sjellë një përvojë të re për publikun, ku **orkestra e Teatrit Kombëtar Shqiptar** do të interpretojë live kolonat zanore më të njohura të kinemasë shqiptare. Performanca do të shoqërohet nga një **ekran i madh LED (Led Ëall)**, në të cilin do të transmetohen fragmente filmike të përzgjedhura nga veprat e interpretuara, duke krijuar një ndërthurje harmonike mes muzikës live dhe imazhit filmik.

Ky koncept artistik, i realizuar në një format modern dhe bashkëkohor, synon të risjellë në kujtesën e publikut trashëgiminë e pasur të filmit shqiptar dhe të promovojë artin muzikor në një mënyrë novatore e gjithëpërfshirëse.

Vallja Shqiptare ne Himare

- a) Aktiviteti **“Vallja Shqiptare”**, i sjellë për herë të parë në qytetin e Himarës nga **Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit**, përfaqëson një ngjarje të rëndësishme kulturore që promovon trashëgiminë shpirtërore dhe artistike të trevave shqipfolëse.
- b) Në këtë shfaqje të veçantë, trupa profesioniste e TKOB do të interpretojë një program të pasur me valle tradicionale nga të gjitha krahinat shqiptare, të shoqëruara me **kostumografi autentike** që pasqyron larminë kulturore të vendit.
- c) Ky aktivitet synon të sjellë pranë publikut vendas dhe turistëve një **përvojë unike kulturore**, duke e kthyer Himarën në një skenë të gjallë të trashëgimisë shqiptare përmes muzikës, vallëzimit dhe ngjyrave të traditës.

“Fjale mbi det ”Nate Poetike “

Aktiviteti **“Fjalë mbi Det”** është konceptuar si një **mbrëmje poetike-artistike** që ndërthur interpretimin e fjalës së bukur me muzikën dhe lëvizjen skenike. Në këtë event do të marrin pjesë **aktorë të njohur të skenës shqiptare, instrumentistë profesionistë dhe balerinë**, duke krijuar një spektakël të ndjeshëm dhe estetik.

Eventi do të zhvillohet në një **vend piktoresk të Himarës**, i përzgjedhur për atmosferën dhe peizazhin e tij të veçantë, duke i dhënë aktivitetit një dimension të fortë emocional e vizual. **“Fjalë mbi Det”** synon të krijojë një përvojë të paharrueshme ku poezia, muzika dhe natyra bashkohen në harmoni të plotë.

“Rrno per me tregue” (Shkruar nga AT ZEF PLLUMI)

Aktiviteti **“Rrno për me tregue”** do të zhvillohet në një mjedis të veçantë kulturor, **Kisha e Vunoit**, duke i dhënë shfaqjes një dimension të veçantë shpirtëror e artistik.

Ky **teatër muzikor**, me interpretimin e aktorit të njohur shqiptar **Arben Derhemi** dhe muzikën nën drejtimin e kompozitorit të njohur **Aulon Naçit**, ndërthur artin skenik dhe muzikën në një rrëfim të fuqishëm mbi qëndresën, besimin dhe dinjitetin njerëzor.

Përmes këtij koncepti artistik të veçantë, publiku vendas dhe vizitorët do të kenë mundësinë të përjetojnë një **mbrëmje të rrallë arti dhe emocioni**, ku historia dhe muzika bashkohen për të sjellë një mesazh të thellë njerëzor dhe kombëtar.

Festivali I Luleve -Edicioni i pare

Aktiviteti **“Festivali i Luleve”** është konceptuar si një ngjarje festive dhe kulturore dyditore, e cila këtë vit do të zhvillohet për herë të parë në **qytetin e Himarës**, pas suksesit të edicioneve të mëparshme në qytete të tjera të Shqipërisë.

Dita e parë do t'i dedikohet **fëmijëve të Himarës dhe zonave përreth**, me një program të pasur argëtues dhe edukativ. Hapësira e festës do të zbukurohet me dekorime lulesh, ndërsa në shëtitoren kryesore do të vendosen tavolina për rreth **150–200 fëmijë**, të cilët do të pikturojnë **vazo balte** dhe do të mbjellin **lule si kujtim** të veçantë, të personalizuar me stikerin **“Bashkia Himarë”**. Më pas, do të zhvillohen lojëra, kërcime dhe aktivitete me **animatorë dhe grupe artistike fëmijësh**.

Dita e dytë do t'i kushtohet **publikut të gjerë**, me një **koncert festiv** ku do të performojnë **grupe të njohura të muzikës moderne, trupa kërcimi dhe artistë të ftuar**, duke e kthyer Himarën në një skenë të gjallë feste dhe gjallërie verore.

Ky aktivitet synon të promovojë **artin, natyrën dhe bashkëjetesën komunitare**, duke e kthyer **“Festivalin e Luleve”** në një simbol të bukurisë dhe gjallërisë së Himarës.

Festa e Akullores

Festa e Akullores në qytetin e Himarës është një aktivitet dedikuar fëmijëve dhe komunitetit, i konceptuar si panair artizanal me prodhues të ndryshëm të akullores dhe produkteve të ëmbla. Ngjarja ofron argëtim me personazhe të dashur për fëmijët, aktivitete interaktive dhe atmosferë festive gjatë gjithë ditës. Në mbrëmje, programi vijon me një aktivitet të madh të dedikuar të rriturve, duke e shndërruar festën në një event gjithëpërfshirës familjar dhe komunitar që nxit turizmin, kulturën lokale dhe socializimin.

Himara Rin Fest 2026

“Himara Rin Fest” është një festival rinor që do të organizohet në qytetin e Himarës, me synim promovimin dhe fuqizimin e talenteve të reja lokale. Ky aktivitet sjell në skenë të rinj të talentuar në këngë, kërcim, poezi, art performues dhe talente të veçanta, duke krijuar një hapësirë motivuese për shprehjen artistike dhe kulturore.

Cdo zhaner do të ketë Trajneret perkates.

Rinn Fest kontribuon në zhvillimin komunitar, rritjen e pjesëmarrjes rinore dhe promovimin e Himarës si një destinacion aktiv kulturor. Përmes këtij konkursi, të rinjtë marrin mundësi të prezantojnë aftësitë e tyre, të ndërtojnë eksperiencë skenike dhe të inkurajohen drejt zhvillimit të karrierës artistike.

Festa e Balonave

Festa e Balonave në qytetin e Himarës është një aktivitet i dedikuar fëmijëve, me fokus argëtimin, kreativitetin dhe pjesëmarrjen komunitare. Aktiviteti përfshin lojëra interaktive, konkursin për balonën më të bukur dhe garën për ngritjen më të lartë të balonave, si dhe animacion dhe koncert të dedikuar kësaj grupmoshe. Festa synon të krijojë një ambient të gëzueshëm, edukativ dhe motivues për fëmijët, duke promovuar socializimin, imagjinatën dhe kulturën komunitare të qytetit të Himarës.

Himara në 3D

(Një destinacion turistik mes vlerash të trashëgimisë historike e kulturore dhe atraksioneve të shumta ende të pazbukurala nga turistët, e sjellë në 3D me imazhe)

Aktiviteti **“Himara në 3D”** është një projekt novator që synon të promovojë trashëgiminë e pasur historike, kulturore dhe natyrore të qytetit të Himarës përmes teknologjisë bashkëkohore. Ky koncept i ri turistik do të vendoset në një nga pikat më të frekuentuara nga **turistët dhe banorët vendas**, duke ofruar një eksperiencë vizuale tërësisht të re.

Në kuadër të aktivitetit do të ngrihen **3–4 stenda interaktive**, të pajisura me **syze virtuale 3D**, ku vizitorët do të kenë mundësinë të udhëtojnë përmes imazheve dhe rikrijimeve digjitale të **trashëgimisë materiale, peizazheve detare dhe pasurive nënujore** të Himarës.

Ky projekt ndërthur **teknologjinë dhe turizmin kulturor**, duke sjellë një formë të re të njohjes së historisë dhe natyrës, si dhe duke nxitur **interesin e vizitorëve për destinacionet ende të pazbuluara** të zonës. **“Himara në 3D”** përfaqëson një **risi për qytetin**, që e pozicionon atë si një shembull të suksesshëm të ndërthurjes së traditës me inovacionin

Himara Photo Festival – Edicioni i Parë

“Himara Photo Festival” vjen këtë vit me **edicionin e parë**, si një thirrje për të gjithë dashamirësit e fotografisë — profesionistë apo amatorë — që duan të tregojnë historinë e qytetit përmes objektivit të tyre. Ky festival synon të **promovojë Himarën si destinacion turistik, kulturor dhe natyror**, duke sjellë në fokus magjinë e saj: detin, njerëzit, trashëgiminë, ngjyrat dhe jetën e përditshme që e bëjnë këtë vend të veçantë.

Konkursi

Nga **5 maj deri më 30 maj 2026**, çdo person i apasionuar pas fotografisë mund të **aplikojë online**, duke dërguar **deri në 3 foto origjinale** që pasqyrojnë **Himarën dhe zonën përreth**, përmes këndvështrimit të tyre kreativ. Të gjitha fotot e pranuar do të publikohen në **faqen zyrtare të Bashkisë Himarë**, ku publiku do të ketë mundësinë të **votojë për fotot e preferuara**.

Çmimet dhe Eventi Final

Fotot më të vlerësuara nga **publiku dhe juria profesionale** do të shpërblehen me **çmime të veçanta** gjatë një **ceremonie festive** që do të organizohet në Himarë. Do të realizohet një **ekspozite** me fotot me të mira në shesh. Në këtë mbrëmje të dedikuar artit të fotografisë do të jenë të ftuar **artistë, personalitete të njohura të artit dhe medias, si dhe përfaqësues të institucioneve kulturore**, duke e kthyer eventin në një **moment të rëndësishëm për promovimin e artit vizual shqiptar**.

Qëllimi i Festivalit “Himara Photo Festival” synon të:

- nxisë **krijimtarinë dhe artin vizual**,
- promovojë **turizmin kulturor e natyror** të zonës,
- krijojë një **platformë bashkëpunimi dhe ekspozimi** për artistë të rinj,
- dhe të vendosë Himarën në **hartën e aktiviteteve kulturore kombëtare**.

November Fest (Koncert me rastin e 28-29 Nëntorit)

Te gjitha eventet dhe datat janë subjekt i ndryshimeve në varesi të nevojave të AK.

Shpërndarja:

- **Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**
- **Planin vjetor të aktiviteteve, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor;**
- **Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim);**
- **Materiale promocionale për çdo aktivitet (postera, banner, përmbajtje digjitale);**
- **Raporte periodike (mujore/tre-mujore) mbi progresin e realizimit;**
- **Raport përfundimtar për çdo aktivitet, që përfshin:**
- **Përshkrimin e aktivitetit;**
- **Numrin e pjesëmarrësve;**
- **Dokumentim fotografik dhe video;**
- **Raport përfundimtar vjetor me analizë të impaktit dhe rekomandime.**
- **Vendi i kryerjes së shërbimeve: Gjithë territori i Bashkisë Himarë**

III.5.2 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet si më poshtë: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e

prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Në nenin 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar është përcaktuar përgjegjësia e autoritetit kontraktor, si më poshtë:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.5.3.Neni 36 “Specifikime Teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, është përcaktuar:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë

apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor. 7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane

III.5.4. Në nenin 41, pikat 1,2, 4,6, dhe 7, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, të VKM-së, nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, parashikon:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme.

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe hartimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit, i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe i specifikimeve teknike më të rëndësishme, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Dokumentet e tenderit, kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit në tërësi të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Dokumentet e Tenderit duhet të jenë të argumentuar qartë dhe saktë bazuar në legjislacionin e prokurimit publik për tu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomikë për të përlogaritur ofertat e tyre por njëkohësisht ato i shërbejnë autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit për të qenë në përputhje me kërkesat e AK-së.

Komisioni nga shqyrtimi i ankesës dhe DST-së, Referuar Proces-Verbalit “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” vëren se autoriteti kontraktor nuk ka hartuar specifikime teknike as edhe preventiv mbi realizimin e aktiviteteve, apo e edhe argumentim të shtojcës 8, Termave të Referencës, e cila rezulton e paplotë, duke u bërë shkak për ankesa në lidhje me hartimin në tërësi të dokumenteve të procedurës së prokurimit.

Referuar ankesës operatori ekonomik ka kërkuar specifikime teknike konkrete për të gjithë aktivitetet objekt prokurimi të cilat janë të nevojshëm për realizimin e aktiviteteve, e konkretisht për mënyrën e disponimit të tyre, përlogaritjen e shpenzimeve për fondin limit, elementet e domosdoshëm për cdo aktivitet, materialet konkrete dhe të matshëm për realizimin e cdo aktiviteti etj.

Nga Informacionet e palëve rezulton se Autoriteti Kontrktor e ka në traditën e tij kryerjen e Aktiviteteve kulturore, artistike, sezonale apo përgjatë vitit, çka do të thotë se i ka të qarta idetë, planifikimet, organizimet, detyrat që do të kryhen nga Autoriteti Kontraktor dhe çdo hollësi në realizimin e tyre, si edhe vënien në dispozicion të operatorëve ekonomikë të çdo materiali ndihmës për të përlogaritur çmimet dhe hartimin e ofertave të tyre në përmbushje të detyrimeve konkrete të operatorëve ekomike.

Me të drejtë Operatori Ekonomik ngre pretendime mbi mungesë të specifikimeve teknike, mangësi në dokumentin Terma të Referencës apo edhe vendosje të përcaktimeve të qarta dhe ndarje të detyrave që i përkasin Autoriteti Kontraktor nga njëra anë dhe Detyrat konkrete për operatorët ekonomikë nga ana tjetër, të cilat duhet të përcaktohen qartë, saktë dhe të plota e të pasqyrohen tek Termat e Reference, sikurse edhe ankimesi ngre pretendime:

(Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor) **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS** Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Detyrat: Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ne shtojcen 8 te publikuar ne proceduren objekt ankimimi thuhet:

Te gjitha eventet dhe datat jane subjekt i ndryshimeve ne varesi te nevojave te AK. Shpërndarja:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë: Planin vjetor të aktiviteteve, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor;

Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim);

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Gjithe territori i Bashkise Himare

Si të pakuptimta, se Planet janë të miratuara nga AK, OE nuk ka ne dore asnje document/plan te miratuar nga AK, madje eshte ne shkelje te ligjit te kete komunikime mes OE dhe AK.

Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim); nderkohe qe po vete ka percaktuar: Te gjitha eventet dhe datat jane subjekt i ndryshimeve ne varesi te nevojave te AK. OE ofertues nuk ka si te percaktoje datat e eventeve perderisa vete AK ka percaktuar se datat do te vendosen ne varesi te nevojave te AK, pra datat jane ne dore te AK.

Vendndodhja dhe shperndarja jane dy elemente ne Termat e References qe duhet ti plotesoje AK per secilin prej eventeve, nuk mund ta vendosin OE ofertues vendin ku do te zhvillohet aktiviteti. Kjo eshte nje procedure prokurimi ku AK ka detyrimin ligjor te hartoje kerkesa te sakta dhe te mirepercaktuara, per me teper eshte edhe marreveshje kuader me te gjitha kushtet te percaktuara. Vendndodhja eshte njera nga kater pikat ne shtojcen e Termave te References qe eshte percaktuar ta plotesoje AK.[...]

Komsioni gjykon se AK duhet ti bëjë pjesë të Shtojcës 8 të gjitha detyrat që do të jenë pjesë e punës së Autoriteti Kontraktor duke përcaktuar saktë dhe në mënyrë shteruese detyrat e tij siç janë: Planin vjetor të aktiviteteve, kohëzgjatja për çdo aktivitet, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor; Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim); Përshkrimin e aktivitetit me detaje; Numrin e pjesëmarrësve; Vendi i kryerjes së shërbimeve: Gjithe territori i Bashkise Himare, (përcaktim evaziv) etj si dhe detyrat/punët që do të kryejë Operatori Ekonomik, duke hartuar specifikime teknike të hollësishme të qarta për çdo aktivitet si edhe plotësim të Termave të Referencës me të dhëna të hollësishme të plota, të qarta dhe të zgjeruara.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

III. 5.6. Përsa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik mbi modifikime si vijon:

Ne termat e references thuhet: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë: **Materiale promionale për çdo aktivitet** (postera, banner, përmbajtje digjitale);

ARGUMENT 8.1 Kjo procedure nuk ka asnje liste për keto materiale promionale, për asnje aktivitet. Mungojnë zerat, sasitë, njesitë matëse, specifikimet. Ju lutem hartoni dhe publikoni listen për keto produkte për secilin aktivitet.

ARGUMENT 8.2 Si është bërë përlogaritja e fondit limit për këto kërkesa, përderisa nuk ekziston asnjë liste.

PROBLEMATIKA 9 Problemi me i madh që ka kjo procedure është që nuk ka **liste produkte, sasi, njesi matëse, specifikime**.

Ne një procedure prokurimi AK ka detyrimin të hartojë çdo kërkesë me detaje. Për asnjë aktivitet nuk jepet asnjë informacion:

Sa kohë do të zgjase **Sa pjesëmarrës kerkohen** Cfare kerkohet nga OE Cfare produkte kerkon AK per realizimin e eventit (skene, foni, produkte promionale, artiste, etj) me cfare sasi, ne cfare permasash, me cfare specifikimesh Cfare jane cmimet qe do te ndahen, cfare vlere kane, jane

materiale apo vleresim ne para **Ne termat e references permenden: Artistë nga vende të ndryshme të Mesdheut, orkestra e Teatrit Kombëtar Shqiptar, Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, aktorë të njohur të skenës shqiptare, instrumentistë profesionistë dhe balerinë,** aktori i njohur shqiptar Arben Derhemi dhe muzika nën drejtimin e kompozitorit të njohur Aulon Naçit, grupe të njohura të muzikës moderne, trupa kërcimi dhe artistë të ftuar [...]

PROBLEMATIKA 14 Ne Kriteret e Vecanta per Kualifikim kerkohet: **2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do shërbejnë për ofrimin e shërbimit të projektimit, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:**

Mjete Transporti mbi 3,5 t; - Sisteme Audio Sisteme Ndriçimi Struktura Skenike Materiale Promovuese Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertues i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENT 14.1 **Materialet Promovuese nuk janë mjete, janë produkte.** Ju lutem hiqni materialet promovuese nga deklaratat që kerkoni dhe, sikurse kemi kerkuar edhe ne piken 8.1 të kësaj ankese, **percaktoni listen e sakte të këtyre materialeve për çdo event.** ARGUMENT 14.2 Kjo procedure nuk ka liste zerash dhe nuk e kuptojmë nga e ka nxjerre AK nevojën për këto mjete. Ne Termat e References nuk ka asnjë fjale për këto mjete, përveç një rasti ku përmendet **ledëall**. I vetmi aktivitet ku përmendet **ledëall** është: Tingujt e Kinemasë Shqiptare - Muzika e Filmit Shqiptar, dhe thuhet: Performanca do të shoqërohet nga një ekran i madh LED (Led Ëall), në të cilin do të transmetohen fragmente filmike të përzgjedhura nga veprat e interpretuara, duke krijuar një ndërthurje harmonike mes muzikës live dhe imazhit filmik.

Si e ka llogaritur AK kapacitetin e mjetit të transportit **mbi 3,5 ton**, kur procedura nuk ka **asnjë listë për mallra që do të transportohen.**

AK e ka lene ne dore te OE te caktojne vete sasine e mjeteve (Sisteme Audio, Sisteme Ndriçimi, Struktura Skenike), atehere nuk ka si te caktojte mjet mbi 3.5 ton, sepse AK nuk ka asnjë informacion se çfarë peshe kanë materialet e OE. Lutemi të hiqet kërkesa për kapacitetin e mjetit mbi 3.5 ton sepse është e paargumentuar dhe e pabazuar në asnjë përloqaritje.

III.5.7 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST , Terma të Referencës , pjesa e pretendimeve të ngritura në ankesë:

[...]Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- Planin vjetor të aktiviteteve, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor;
- Kalendarin e detajuar të eventeve (me data, vendndodhje dhe përshkrim);
- Materiale promocionale për çdo aktivitet (postera, banner, përmbajtje digjitale);
- Raporte periodike (muajt/tre-muajt) mbi progresin e realizimit;
- Raport përfundimtar për çdo aktivitet, që përfshin:
- Përshkrimin e aktivitetit;
- Numrin e pjesëmarrësve;
- Dokumentim fotografik dhe video;
- Raport përfundimtar vjetor me analizë të impaktit dhe rekomandime.
- Vendi i kryerjes së shërbimeve: Gjithë territori i Bashkisë Himare

Kriterin 2.3.6, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do shërbejnë për ofrimin e shërbimit të projektimit, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- Mjete Transporti mbi 3,5 t;
- Sisteme Audio
- Sisteme Ndriçimi
- Struktura Skenike
- Materiale Promovuese

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi/kontrata qiraje/kontrata huapërdorje/kontratë dhurimi/çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertues i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar Pr-V për Argumentimin e Kritereve për Kualifikim: ka

Argumentim: Vendosja e kriterit për deklarimin dhe vërtetimin e disponueshmërisë së mjeteve dhe pajisjeve teknike është e domosdoshme për të garantuar kapacitetin real të operatorit ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit, i cili përfshin organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve artistike dhe kulturore me kërkesa të larta logjistike dhe teknike.

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën e shërbimeve dhe argumentohet si më poshtë:

Sigurimi i kapaciteteve teknike të nevojshme: Organizimi i eventeve kërkon pajisje specifike si sisteme audio, ndriçimi, struktura skenike dhe mjete transporti për instalim dhe shpërndarje. Kërkesa për deklarimin dhe dokumentimin e tyre garanton që operatori ekonomik disponon mjetet e nevojshme për realizimin e shërbimeve.

Garantimi i realizimit cilësor të aktiviteteve: Cilësia e një aktiviteti artistik varet drejtpërdrejt nga infrastruktura teknike (zëri, ndriçimi, skena). Ky kriter siguron që operatorët pjesëmarrës janë të aftë të ofrojnë standarde profesionale në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Menaxhimi i komponentit logjistik: Mjetet e transportit mbi 3.5 ton janë të domosdoshme për transportin e pajisjeve dhe strukturave skenike, veçanërisht për aktivitete të shpërndara në disa lokacione. Kjo garanton që operatori mund të përballojë ngarkesën logjistike të kontratës.

Disponueshmëria reale dhe jo deklarative: Kërkesa për dokumentacion provues (pronësi, qira, huapërdorje, etj.) siguron që pajisjet janë realisht të aksesueshme nga operatori ekonomik dhe nuk deklarohen vetëm formalisht për qëllime kualifikimi.

Fleksibilitet në mënyrën e disponimit: Lejimi i disa formave të disponimit (pronësi, qira, huapërdorje, dhurim, etj.) është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe garanton respektimin e parimit të mosdiskriminimit, duke mundësuar pjesëmarrjen e një game më të gjerë operatorësh ekonomikë.

Reduktimi i riskut në fazën e zbatimit: Duke kërkuar që operatorët të provojnë paraprakisht disponueshmërinë e mjeteve, Autoriteti Kontraktor minimizon rrezikun e vonesave, dështimit të aktiviteteve apo marrjes së shërbimeve me cilësi të ulët.

Përputhshmëria me parimin e proporcionalitetit: Lista e mjeteve të kërkuara është minimale dhe e lidhur drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, pa vendosur barriera të panevojshme për pjesëmarrje.

III.5.8 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretishtmjetet e nevojshme.

Referuar Pr-V, mbi argumentuin e Kriterit 2.3.6, Autoriteti e ka argumentuar kriterin dhe rëndësinë e tij por nuk ka dhënë specifikime teknike të hollësishme dhe orientuese për mjetet e listuara në kriter.

Komisioni në analizë të fakteve sipërcituar gjykon, që Autoriteti Kontraktor në mënyrë që të shmangë çdo konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit, duke mbajtur në konsideratë pretendimet e ankimuesit lidhur me pyetjet e ngritura në ankesë dhe çdo sqarim të kërkuar, gjykon se: Autoriteti Kontraktor duhet të të modifikojë ndjeshëm dhe të përcaktojë me hollësi të dhëna për cdo material/mjet të kriteri 2.3.6 dhe ti bëjë pjesë **të shtojcës 9 por edhe tek shtojca 8, Termat e Referencës**, të gjitha materialet mbështetëse për realizimin e çdo aktiviteti konkret, me një listë përkatëse me mjetet/pajisje të me specifikime /parametra, përmasat, fuqi, apo edhe ilustrime të ngjashme etj, duke përshkruar në mënyrë të saktë dhe shteruese çdo element në funksion të shërbimeve/aktiviteteve që kërkohet dhe do të realizohen nga ofertuesit si edhe detyrat e Autoritetit Kontraktor.

Gjithashtu në lidhje me pretendimet mbi modifikime **të Kriterit 2.3.6**, Autoriteti kontraktor sic u argumentuar më sipër duhet të përcaktojë qartë dhe saktë të dhëna të sakta mbi **mjetet e transportit** kërkuar në këtë kriter, të justifikojë se përse e kërkon tonazhin e përcaktuar si edhe të vendosë diapazon në përcaktimin e tonazhit.

Hartimi i specifikimeve teknike, kërkesave edhe kriterëve kualifikues në mënyrë jo të plotë, shkakton paqartësi të cilat ndikojnë jo vetëm tek operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave të tyre, por edhe vështirësojnë punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët do të detyrohen të vlerësojnë procedurën mbi dokumentacion të paqartë, konfuz, të paargumentuar.

Komisioni gjykon që Autoriteti Kontraktor duhet të modifikojë ndjeshëm dokumentet e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme dhe pretendimeve të ankimuesit, në të kundërt të anulojë procedurën si rezultat i mangësive të theksuara vërejtur në DST.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.6. Përsa i përket pretendimeve për modifikime të kriterëve kualifikues e konkreteisht:

ARGUMENT 12.1 Profesione Drejtues Artistik dhe Menaxher Event nuk ekzistojne ne VKM 514 datë 20.9.2017 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lkp) të rishikuar. Ju lutem percaktoni profesione sipas listës se miratuar te profesioneve, pasi ne listen e miratuar jane edhe percaktimet ligjore se cfare arsimimi duhet te kene keto profesione.**ARGUMENT 12.4** Per sa kohe qe kuadri ligjor dhe Kodi i Punes lejon edhe punesimin me kontrata sherbimi, nuk ka pse AK ta perjashtoje kete mundesi punesimi. Ne procedura te ndryshme kerkohen specialiste te profileve te ndryshme, nuk ka arsye pse te detyrohen OE te punesojne gjithë keta specialiste, nderkohe qe OE bashkepunojne permes kontratave te sherbimit me specialiste te ndryshem, sa here qe lind nevoja. Lutemi te ndryshohet kriteri dhe te pranohen te angazhuar me kontrata sherbimi apo marreveshje

bashkepunimi, ne menyre qe kriteri te jete sa me gjithepershires dhe te mundesoje ofertimin e OE qe merren me organizme eventesh, edhe nga biznesi i vogel dhe i mesem. Lutemi mbani parasysh qe me gjasa kjo procedure do te ndahet ne lote, dhe nuk eshte aspak propocionale qe per nje apo dy lote qe mund te fitoje nje OE, pra organizimin e nje apo dy festave, te punesoje te ashtuquatur **Drejtues Artistik** (te ashtuquajtur sepse ky profesion nuk ekziston). Ne lidhje me kete kriter AK ka hequr edhe te drejten e mbeshtetjes ne kapacitetet e nje OE tjeter, duke penguar dhe kufizuar teresisht ofertimin. Ne proces-verbalin e argumentimit te kriterit nuk ka asnje argument se perse keto specialiste duhet te jene patjeter te punesuar dhe pse nuk lejohet angazhimi i tyre me kontrata sherbimi, duke e bere kriterin te paargumentuar si teknikisht ashtu edhe ligjesisht. Nuk ka asnje argument pse OE duhet ti kete te punesuar keta punonjes. Ne cmenyre demtohet Ak nese keta specialiste angazhohen me kontrata sherbimi nga OE. Pergjegjes per realizimin e kontrates eshte OE si entitet, dhe jo nje specialist i caktuar. Persa kohe OE merr persiper pergjegjesite e veta dhe paraqet kontrata sherbimi me specialistet, eshte ne pergjegjesine e OE te siguroje qe sherbimi do te realizohet sipas specifikimeve teknike te procedures. **Edhe nje here kerkojme qe te lejohet angazhimi i specialisteve edhe me kontrata sherbimi, pasi te percaktohet qarte profili i tyre bazuar ne liten kombetare te profesioneve.**

ARGUMENT 12.5 Kjo procedure nuk ka liste sherbimesh. Ku eshte bazuar AK per te caktuar specialistet qe kerkohen, kur AK nuk ka percaktuar cfare sherbimesh kerkon nga OE, nuk ka percaktuar specifikime teknike, nuk ka liste zerash, nuk ka sasi. Mbase pas percaktimit te listes do te rezultojte qe keta specialiste nuk kane lidhje me cfare kerkohet nga OE ne kete procedure. Per me teper AK ka hequr edhe te drejten e mbeshtetjes ne kapacitetet e nje OE tjeter per kete kriter, duke kufizuar teresisht konkurrencen. Kjo e ben kriterin per specialistet te paargumentuar.....

ARGUMENT 12.6 Ne kriter kerkohet qe te paraqiten: jetëshkrim (CV , diploma, trajnime ose ekuivalent. Sipas nenit 41, pika 4.b, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, ne RrPP thuhet: një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. **Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit perkates; dhe/ose Lutemi te shtohen fjalet kur kanë të tilla sipas legjislacionit prkates per trajnimet qe kerkohen per specialistet. Pra per specialistet te kerkohen: jetëshkrim (CV), diploma, trajnime ose ekuivalent, kur kanë të tilla sipas legjislacionit perkates. Legjislacioni perkates qe percakton trajnimet eshte lista kombetare e profesioneve, prandaj edhe nje here lutemi te percaktohen profesionet sipas listes kombetare te profesioneve ku percaktohet ligjesisht se cfare arsimimi dhe cfare trajnimi duhet te kete cdo profesion.**

III.6.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar ne DST shtojcen 9, **2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, Kriteri 2.3.5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik kyç për ekzekutimin e objektit te prokurimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, jetëshkrim (CV) , diploma, trajnime ose ekuivalent si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:**

- Minimumi 1 (nje) Drejtues Artistik, me min 5 (pesë) vite eksperiencë profesionale.
- Minimumi 1 (nje) Grafik Dizainer(Graphic Designer), me min 2 (dy) vite eksperiencë profesionale
- Minimumi 1 (nje) Menaxher Eventi, me min 10 (dhjetë) vite eksperiencë profesionale.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentuar: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pajisje, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me realizimin e shërbimit.

III.6.2. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 i LPP-së, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje

me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik.

III.6.4. Komisioni gjykon se personeli i ekspertëve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor do të jetë në funksion të realizimit të aktiviteteve objekt prokurimi të cilat nuk mund të realizohen pa një personel të kualifikuar sic janë ekspertët e kërkuar në kriterin 2.3.4 dhe kriteri është mëse i nevojshëm në funksion të realizimit të aktiviteteve por sikurse edhe ankimuesi ngre *pretendime në lidhje me përcaktimin e profesione sipas Listës Kombëtare të Profesioneve të Miratuar, Komisioni gjykon se autoritetin kontraktor duhet të argumentojë qartë e saktë vendosjen e kriterit objekt ankimi, të vendosë profesionet e duhuar ose ekuivalente. Autoriteti të modifikojë kriterin duke përcaktuar saktë llojin e profesioneve të ekspertëve dhe dokumentet shoqëruese për tu paraqitur, në përputhje me bazën ligjore përkatëse.*

Përsa i përket pretendimeve për mënyrën e punësimit të stafit teknik Komisioni gjykon, se referuar përcaktimit në nenin 41 të VKM 285 datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor, duhet të kërkojë një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë certifikata , diploma përkatëse., kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, dhe të jetë në marrëdhënie punësimi gjatë periudhës së zhvillimit të aktiviteteve, pra ligjvënësi ka përcaktuar qartë kërkesat në lidhje me provueshmërinë e kapacitetit profesional.

Komisioni gjykon për rastin konkret, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës, të sigurohet, që operatori ekonomik, i cili do të shpallet fitues, të ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme teknike dhe profesionale për përmbushjen me sukses të kontratës, për këtë arsye, duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke kërkuar, që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë stafin sipas kualifikimeve të nevojshëm, por pa e kufizuar mënyrën se si e disponon, me personel të punësuar si pranë subjektit ofertues apo me kontrata shërbimi për të gjithë kohën e zhvillimit të procedurës deri në përfundim të realizimit të saj.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht.

III.7. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik argumentuar si vijon:

Argumenti 13. *Ne Kriteret e Vecanta per Kualifikim kerkohet: 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:*

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 14001-2015,

Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015. Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argument 13.1 Si ne rastin kur kërkon ISO 9001:2015, edhe kur kërkon ISO 45001-2018, AK ka shtuar fjaline Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015 .

Lutemi sqaroni çfare do te thote ky shenim. Ne rast bashkimi OE nuk kerkohet ISO 9001:2015, dhe ISO 45001-2018 per nje anetar te bashkimit?

Nderkohe ne fund te kriterit thuhet: Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit. Lutemi sqaroni çfare kerkoni.

Argument 13.2 AK kërkon: Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 14001-2015, Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

Kerkesa nuk ka kuptim: vetem njeri anetar i grupit duhet ta kete kete certifikim, dhe antaret e tjere jo?

Nderkohe ne fund te kriterit thuhet: Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Lutemi sqaroni çfare kërkon.

III.7.1 Autoriteti Kontraktor ka publikuar shtojcën 9, Formular i Kritereve për Kualifikim, Kriterin:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 45001-2018**, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 14001-2015**, Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt

prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 9001:2015** me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 45001-2018** me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përm bushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

SSH/DIN/EN/UNI/ISO ISO 14001-2015, Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, një anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.

Ndikimi mjedisor i aktiviteteve: Organizimi i eventeve artistike dhe kulturore (koncerte, festivale, aktivitete publike) shoqërohet me prodhim mbetjesh, konsum energjie, përdorim materialesh promocionale dhe ndikim në hapësirat publike. Prania e një sistemi të certifikuar të menaxhimit mjedisor garanton që operatori ekonomik ka procedura për minimizimin e këtij ndikimi.

Respektimi i legjislacionit mjedisor: Operatorët me ISO 14001 kanë struktura të brendshme që sigurojnë përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, duke reduktuar rrezikun e shkeljeve dhe penaliteteve për Autoritetin Kontraktor.

Menaxhimi i qëndrueshëm i eventeve: Ky standard siguron që aktivitetet të organizohen sipas praktikave të qëndrueshme, duke përfshirë:

reduktimin e mbetjeve,

riciklimin,

përdorimin efikas të burimeve,

minimizimin e ndotjes akustike dhe vizuale.

Rritja e cilësisë dhe imazhit institucional: Zbatimi i standardeve ndërkombëtare kontribuon në përmirësimin e imazhit të Autoritetit Kontraktor si institucion që promovon zhvillimin e qëndrueshëm dhe praktikën e përgjegjshme mjedisore.

Proporcionaliteti i kërkesës: Kërkesa për një certifikatë të vetme ISO është në përpjesëtim me natyrën e kontratës dhe nuk përbën barrë të tepruar për operatorët ekonomikë që operojnë në këtë sektor.

Fleksibiliteti në rast BOE (bashkim operatorësh): Parashikimi që në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, certifikata mund të paraqitet nga një prej anëtarëve, siguron respektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe nxit pjesëmarrjen në procedurë.

III.7.2. Neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, indryshuar, parashikon shprehimisht se :

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.

III.7.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit në përcaktimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimeve në funksion të realizimit me sukses të kontratës dhe si rrjedhojë është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriterë dhe specifikime teknike në funksion të procedurës së prokurimit. Është detyrë e njërive përkatëse të mirëargumentojnë vendosjen e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike me qëllim që të jenë hartimin sa më të plotë dhe të saktë, të japin informacion të mjaftueshëm për operatorët ekonomikë të cilët do të ofertojnë në kryerjen e shërbimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar informacionit të autoritetit kontraktor në lidhje me pikën sipërcituar të ankesës gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime/saktësime mbi kriterin objekt ankimi që sipas operatorit ekonomik është i paqartë.

Komisioni gjykon se është në të drejtën e operatorëve ekonomikë të bëjnë ankesa dhe t’i argumentojnë ato në lidhje me dokumentacionin e procedurës së prokurimit se si ndikojnë në procesin e hartimit dhe dorëzimit të ofertave në procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

Nga shqyrtimi i ankesës Komisioni vëren se operatori ekonomik ka argumentuar qartë pasaktësitë e konstatuara në dokumentet e procedurës së prokurimit, të cilat vlerësohen të drejta.

Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e vendosjes së kriterit nga autoriteti kontraktor, por në thelb janë paqartësi dhe pasaktësi në hartimin e tij duke kërkuar: [...]Lutemi sqaroni çfare kërkon në kriter. [...]

Gjithashtu, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, KPP vëren, se autoriteti kontraktor, në informacionin e përcjellë në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me Vendimin e KSHA-së nuk ka argumentuar qëndrimin kundër mbi pretendimet sipërcituar në këtë pikë të ankesë, madje konstatohet se AK nuk e argumenton qartë trajtimin e kësaj pike të ankesës, Komisioni gjykon se Vendimi i KSHA-së me argumentimet e tij është i paqartë.

Komisioni në referim të dokumenteve të dosjes administrative dhe në kuadër të garantimit e respektimin të parimeve të transparences, barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomikë dhe konkurrencës së ndershme, kërkon që Autoriteti Kontraktor të rishikojë kriterin 2.3.5 të japë sqarime të plota dhe shteruese lidhur me paqartësitë e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik.

Sqarimet e detajuara janë të domosdoshme për të siguruar një kuptim të saktë të kërkesave dhe për të shmangur interpretime të ndryshme që mund të ndikojnë në përgatitjen e ofertës dhe në zhvillimin në kohë të procedurës së prokurimit por edhe për një proces vlerësimit sa më të drejtë të ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO.

Duke qenë se operatori ekonomik ka paraqitur pyetje dhe paqartësi konkrete në lidhje me sa më sipër cituar konsiderojmë se Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të japë përgjigje të qarta, të argumentuara në mënyrë shteruese për çdo pretendim të ankimuesit për të siguruar dhe garantuar ligjshmërinë e procedurës si edhe realizimin në kohë të saj.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dhënia e sqarimeve por edhe modifikimet nga autoriteti kontraktor jo vetëm është mëse e domosdoshme dhe këto sqarime në kuptim të nenit 75 të Ligjit Nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, duhet të publikohen në shtojcën për ndryshimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me qëllim që operatori ekonomik ankimues si dhe të gjithë operatorët e tjerë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto modifikime dhe sqarime.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, 115/b dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Endri Dulellari” P.F për procedurën e prokurimit *“Procedure e Hapur”*, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Endri Dulellari” P.F për procedurën e prokurimit *“Procedure e Hapur”*, me Nr. REF-82186-04-16-2026, me objekt “Organizim i aktiviteteve gjithëvjetoare artistike dhe kulturore”, me fond limit: 49,518, 900 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.05.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarime përkatëse në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet me shtojcë, në Sistemin Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Endri Dulellari” P.F.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date: 2026/06/12 13:38:33 +02'00"
99384cd165ad4d59bb331c3374a813592026061213383
175020

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2026.06.12
01:44:31